



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION  
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE  
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrimit

Office of the Minister

Kabineti i Ministrimit

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

### Ndërprerja e punës së institucionit edukativo-arsimor, aftësues dhe shkencor

NUMËR: MASHT [I] 45/2005

DATË: 28. 09.2005

Në bazë të nenit 5.4 b) , g) të Ligjit mbi Inspektionin e Arsimit në Kosovë dhe në bazë të nenit 1.3 pika ç) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetqeverisëse në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr:

#### Neni 1

##### Qëllimi

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim që të përcaktojë rastet dhe procedurën e ndërprerjes së punës së institucioneve edukative, arsimore, aftësuese dhe shkencore të cilat nuk i plotësojnë kushtet për punë në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

#### Neni 2

##### Ndalimi i punës së institucionit arsimor

Inspektori i arsimit me vendim do të ndalojë punën e institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues nëse konstaton se:

- a) institucioni edukativo- arsimor dhe aftësues është i palicencuar;
- b) rrezikon jetën e fëmijëve, nxënësve, vijuesve aftësuesve, studiuesve dhe punëtorëve të tjerë nga gjendja fizike e objektit;
- c) nuk ka ujë të mjaftueshëm, ose uji është i ndotur;
- d) objekti edukativo-arsimor dhe aftësues rrezikohet nga zjarri;
- e) objekti edukativo-arsimor rrezikohet nga orteku;
- f) objekti edukativo- arsimor rrezikohet nga vërshimet e ujit;
- g) higjiena dhe nyjet sanitare paraqesin rrezik për shëndetin e fëmijëve, studentëve dhe punëtorëve;
- h) nuk ka ngrohje gjatë sezonës dimërore;
- i) institucioni edukativo-arsimor dhe aftësues është në shënjestër të grupeve terroriste;
- j) rrezikimi nga epidemitë në institucion dhe mjedis.

### **Neni 3**

#### **Dhënia e vendimit**

- 3.1. Inspektori i arsimit nëse konstaton se rreziqet nga pika b.c.d,e, h, j, të nenit 2 janë evidente për çdo moment, lëshon vendimin e përkohshëm për ndërprerjen e punës dhe ai vendim duhet të zbatohet menjëherë. Pas marrjes së vendimit për ndërprerje të përkohshme të punës, inspektori i arsimit përpilon procesverbalin për gjendjen në shkollë dhe në bazë të tij nxjerr vendimin definitiv.
- 3.2. Në raste të tjera vendimi merret në afat prej 15 ditësh.
- 3.3. Në rast të moszbatimit të vendimit të inspektorit do të shqiptohen sanksionet e parapara në Ligjin për Inspektionin e Arsimit.

### **Neni 4**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

---

**Agim Veliu, ministër**